



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHËNDETËSISË / MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jabotaja Org. Javna	02
N. Prot. N. Prot.	05-4792
Nr. i faqeve Br. stranic No. pages	-4-
Data Datum	09/08/2023
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë / Ministry of Health / Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE

MENAXHIMI I MBETURINAVE KIMIKE

VERSIONI: [1.0]
DATA E APROVIMIT: [07/08/2023]
AUTOR: [MSh]
NR. I HAPAVE: [V]
NR. I NËNHAPAVE: [XII]

APROVUAR: *pis* Dr. Naim Bardiqi,
Sekretar i Përgjithshëm, MSh



QËLLIMI	<p>QËLLIMI I PROCEDURËS STANDARDE OPERATIVE (PSO) ËSHTË DEFINIMI I HAPAVE KONKRET TË VEPRIMIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE KIMIKE NË INSTITUCIONE SHËNDETËSORE ME QËLLIM TË MBROJTJES SË SHËNDETIT TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSOR, SHËNDETIT PUBLIK DHE TË MJEDISIT.</p> <p>KJO PSO DUHET TË ZBATOHET NË TË GJITHA INSTITUCIONET SHËNDETËSORE TË CILAT GJENEROJNË MBETURINA KIMIKE.</p>
NDËRLIDHJA ME AKTET	<ol style="list-style-type: none"> 1. LIGJI NR 04/L125 PËR SHËNDETËSI; 2. LIGJI NR. 04/L-060 PËR MBETURINA; 3. UA MMPH NR 10/2015 PËR TRAJTIMIN E MBETURINAVE NGA PRODUKTET MEDICINALE.
LISTA E SHKURTESAVE & DEFINICIONET	<p>MMPHI - MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS;</p> <p>MSH - MINISTRIA E SHËNDETËSISË;</p> <p>PPM - PAJISJE PERSONALE MBROJTËSE;</p> <p>PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE;</p> <p>UA - UDHËZIM ADMINISTRATIV;</p> <p>MBETURINA KIMIKE – JANË MBETURINA QË PËRMBAJNË SUBSTANCA KIMIKE (P.SH. REAGJENTË LABORATORIKË; ZHVILLUES FILMI; DEZINFEKTUES QË KANË SKADUAR OSE NUK NEVOJITEN MË; TRETËS; MBETJE ME PËRMBAJTJE TË LARTË TË METALEVE TË RËNDA, P.SH. BATERITË; TERMOMETRA TË PRISHUR DHE MATËS TË TENSIONIT TË GJAKUT);</p> <p>MBETURINAT KIMIKE KONSIDEROHEN SI TË RREZIKSHME NËSE KANË NJË NGA VEÇORITË SI PSH. TOKSIKE, KORROZIVE (ACIDET), TË DJEGSHME, REAKTIVE DHE OSKIDUESE.</p> <p>MBETURINAT KIMIKE JO TË RREZIKSHME PËRBËHEN NGA KIMIKATE ME ASNJË NGA VETITË E MËSIPËRME; PËR SHEMBULL, SHEQERNAT, AMINOACIDET DHE DISA KRIPËRA ORGANIKE DHE INORGANIKE, TË CILAT PËRDOREN GJERËSISHT NË LËNGJE TRANSFUZIONI.</p>

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Klasifikimi i Mbeturinave Kimike	<ul style="list-style-type: none"> a) Tretësirat e halogjenizuara (Chloroform, methylene chloride, perchloroethylene, refrigerants, trichloroethylene) b) Tretësirat e pahalogjenizuara (Acetone, acetonitrile, ethanol, ethyl acetate, formaldehyde, isopropanol, methanol, toluene, xylenes) c) Dezinfektuesit e halogjenizuar (Calcium hypochlorite, chlorine dioxide, iodine solutions, iodophors, sodium dichloroisocyanurate, sodium hypochlorite (bleach)) d) Aldehidet (Formaldehyde, glutaraldehydes, ortho-phthalaldehyde) e) Alkoolet (Ethanol, isopropanol, phenols) f) Dezinfektuesit tjerë (Hydrogen peroxide, peroxyacetic acid, quarternary amines) g) Metalet (Arsen, kadmium, krom, plumb, merkur, argjend) h) Acidet (Acetic, chromic, hydrochloric, nitric, sulfuric) i) Bazat (Ammonium hydroxide, potassium hydroxide, sodium hydroxide); j) Oksiduesit (zbardhues, hydrogen peroxide, potassium dichromate, potassium permanganate); k) Reduktuesit (Bisulfat sodium, sulfat sodium); l) Të tjera (anestetikët inhalatorë, azbesti, ethylene oxide, herbicidet, paints, pesticidet, mbeturina vajore).
[II]	Shenjëzimi	<ol style="list-style-type: none"> 1. Referohu shenjave të rrezikut nga prodhuesi! 2. Në kutitë/kanisterët e mbeturinave duhet shënuar veçoria e mbeturinës kimike; 3. Çdo kuti/kanister duhet shenjëzuar sipas rekomandimeve të prodhuesit.
[III]	Ruajtja e Mbeturinave Kimike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbeturinat kimike, sidomos ato fotokimike, aldehidet (formaldehidi dhe glutaraldehidi) dhe ngjyruarit nuk duhet hedhur në rrjetin e kanalizimit, por duhet grumbulluar si të veçanta, dhe të trajtohen si mbeturina kimike!; 2. Mbeturinat kimike ruhen përkohësisht në një hapësirë të veçantë të Institucionit, derisa të transportohen për asgjësim!; 3. Mbeturinat kimike të ndezshme ruhen në vend të veçantë, në dollapë metalikë të shenjëzuar!; 4. Mbeturinat kimike të lëngshme ruhen në kanisterë të posaçëm, për të parandaluar rrjedhjen e tyre!; 5. Mbeturinat kimike të ngurta ruhen në dollapë, në kuti, sipas veçorive të tyre kimike!; 6. Nuk duhet manipuluar me mbeturinat kimike me afat të skaduar, por duhet hedhur në vendin adekuat sipas veçorive të tyre ose eventualisht të kthehen te prodhuesi sipas procedurave.

[IV]	Transporti i Mbeturinave Kimike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Transporti i mbeturinave kimike duhet bërë me kujdes nga personi përgjegjës duke përdorë PPM; 2. Mbeturinat kimike pas grumbullimit në hapësirën e përkohshme, transportohen në depon qendrore të mbeturinave medicinale të institucionit;
[V]	Asgjësimi i Mbeturinave Kimike	<ol style="list-style-type: none"> 1. Asgjësimi i mbeturinave kimike duhet të bëhet sipas standardeve të përcaktuara nga MMPHI.

Sqarim: emrat e substancave kimike janë në origjinal (anglisht) për shkak të lehtësimit të menaxhimit nga institucionet!

Referenca:

1. *Safe management of wastes from health-care activities Second edition Edited by Yves Chartier, Jorge Emmanuel, Ute Pieper, Annette Prüss, Philip Rushbrook, Ruth Stringer, William Townend, Susan Wilburn and Raki Zghond, World Health Organization 2014.*